

Njoftim për Shtyp

Zhvillohet mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 13.10.2023, ora 14.00 u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë.

Në prezencë të të gjithë anëtarëve dhe në përputhje me rendin e ditës, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc vazhdoi procesin e verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore për dymbëdhjetë kandidatëve të tjerë.

Pas shqyrtimit dhe diskutimeve të zhvilluara në lidhje me disa elementë kryesorë të vlerësimit të kriterëve ligjore dhe çështjeve specifike që kërkojnë një vendimmarrje, Komisioni vendosi:

1. Marrjen e informacionit të hollësishëm në lidhje me shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore për kandidatët për të cilët Komisioni evidentoi mospërputhje apo paqartësi në lidhje me dokumentacionin e paraqitur;
2. Vendimet për skualifikimin e kandidatëve për të cilët deri më tani është konstatuar mosplotësimi i një apo më tepër kushteve ligjore, do të bëhen publike pasi të kenë ardhur përgjigjet nga institucionet përkatëse të cilave i'u është kërkuar informacion nga Komisioni në lidhje me përmbushjen nga kandidatët të kriterit të integritetit.

Mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc do të njoftohet në një moment të dytë.